



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E SHËRBIMIT PYJOR,BUJQËSISË,MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Nr. 602/Prot.

Gramsh, më 01.03.2021

Lenda : **Dërgim Informacioni.**

Drejtuar : **Znj.Fatbardha NERGJONI**

Adresa : "Hotel Turizmi Skampa"

ELBASAN

Në përgjigje të Tuajës nr.310 prot,datë 14.10.2020 "Kërkesë për informacion", e protokolluar në Bashkinë Gramsh me NR.REGJ. 602,datë 17.02.2021, ju informojmë si më poshtë vijon :

Në zbatim të ligjit nr.57/2020 "Për Pyjet", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.433,datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike,sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish Komunave/Bashkive" i ndryshuar,të VKM-së nr.1353,datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës,mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe kriterëve të zvogëlimit të sipërfaqjes e të vëllimit të fondit pyjor"i ndyshuar,pika 5, gërma ç,në VKM-në nr.1374,datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen,shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor" i ndryshuar,pika 6, gërma d, të VKM-së nr.1064,datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në VKM nr.391,datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave" të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.01,datë 09.06.2016 "Për rregullat,procedurat e kërkimit,të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik",Drejtoria e Shërbimit Pyjor,Bujqësisë,Mbrojtjes së Konsumatorit si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë Bashkisë Gramsh,harton raportin tekniko-ekonomit për dhënien në përdorim/heqje të fondit pyjor e kullosor ,sipas legjislacionit të lartcitur dhe në Këshillin Bashkiak dërgohet dokumentacioni për shprehje dakortësie për heqje nga fondi pyjor e kullosor dhe për këtë ju informojmë sipas pyetjeve që na keni dërguar.

1.Nga Këshilli Bashkiak Gramsh nuk jepen lejet për ndërtimin e operimit të Hec-ve,por jepet dakortësia për fillimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor dhe kullosor,ku nga Këshilli Bashkiak Gramsh është dhënë dakortësia për heqjen nga fondi pyjor e kullosor për 8 (tetë) Hece.

2.Këshilli Bashkiak nuk shqyrton lejet dhe nuk ka kompetence për refuzimin e tyre pasi lejet për ndërtimin e Hec-ve e japin Institucione të tjera qendrore.

3.Nuk kemi informacion nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit mbi numrin e lejeve të miratuara, pasi ato vijnë një nga një sipas rastit të miratuar në këtë ministri.

4.Zbatimin e Kontratës të lidhur midis palëve për ndërtimin dhe operimin e Hec-ve e ndjek Drejtoria e Shërbimit Pyjor,Bujqësisë,Mbrojtjes së Konsumatorit si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë Bashkisë Gramsh.

5.Bashkia Gramsh me strukturat e saj ndjek procesin e ndërtimit sipas projektit,pagesat përkatëse sipas Kontratës së lidhur midis palëve si dhe detyrimet e tjera të përcaktuara në Kontratë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

KRYETARI

Klodian TACE



602/1



[Handwritten signature]

Pranerimale e kësaj pasaportë

u verifikuar




| | | |
|------------------------|-------------------------------------|----------|
| KTHEHET | | Mod E-10 |
| IPANJOHUR | <input type="checkbox"/> | |
| LARGUAR | <input type="checkbox"/> | |
| ADRESË E PA MENDUESHME | <input type="checkbox"/> | |
| KA ANDRSHUAR | <input type="checkbox"/> | |
| ADRESË | <input type="checkbox"/> | |
| OBJEKTI I PA KËRKUAR | <input checked="" type="checkbox"/> | |
| REFUZUAR | <input type="checkbox"/> | |
| ADRESË E PASAKTE | <input type="checkbox"/> | |
| DATA E KTHIMIT | <input type="checkbox"/> | |

Znj. Fatbardha Morigjoni

Hotel Turizmi Skampa

Elbasan



RR388485525AA

U
ESE